VENDIM
Nr.240, datë 21.4.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.88, DATË 1.3.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE " PËR MIRATIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën "B" të pikës 1 të vendimit nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, "Ksamili" zëvendësohet me "Territoret jashtë vijës kufizuese të Ksamilit".
2. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano